



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 1132/4 Prot.

Tiranë, më 7/11/2013

**Lënda:** Rekmandim mbi kontrollin administrativ të zhvilluar pranë kontrolluesit "Bar OSLO" fizik Tiranë

**REKOMANDIM**

Nr. 42 datë 07/11 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Bar OSLO" regjistruar si person fizik në emër të Tiranë

**KONSTATOVA**

Në datë 24/10/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, "Bar OSLO" regjistruar si person fizik në emër të Tiranë me objekt;

- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe udhëzimeve specifike për këtë lloj mbledhje përpunimi të dhënave personale.

Kontrolluesi "Bar Oslo" është kontrollues privat i regjistruar person fizik me emër subjekti fizik , zhvillon aktivitet tregtar lokal shërbimi në Tiranë.

Në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit tuaj merrni cilësinë e kontrolluesit privat, pasi mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë" dhe "punonjës"

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në nenin 3 përkufizon; "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Nga kontrolli i ushtruar u konstatua se në ambientet ku ushtroni veprimtarinë e tuaj gjenden të vendosura disa kamera vëzhgimi, nëpërmjet të cilave ju mblidhni dhe përpunoni imazhe të subjekteve të të dhënave personale, duke u bërë në këtë mënyrë objekt i zbatimit të kushtëve



dhe kriterëve ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në aspektin e përpunimit dhe ruajtjes së tyre. Kamerat e vëzhgimit u konstatuan të vendosura brenda ambientit të lokalit, në hyrje të tij dhe në një rast u konstatua një kamera e vendosur me fokus në hyrje të paradhomës së tualeteve të lokalit.

Pavarësisht qëndrimit tuaj si kontrollues se përdorimi i kamerave CCTV është bërë për parandalim dhe evidentim të fenomeneve të ndryshme që ndodhin në ambientet e lokalit si, grindje, humbja e sendeve të klientëve etj, nga grupi i kontrollit administrativ është konstatuar se ju në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave të subjekteve por për këtë lloj përpunimi të dhënash nuk keni mbajtur parasysh kushtet dhe kriteret që parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e Dhënave Personale” dhe udhëzimit nr.3 datë 5/03/2010 i ndryshuar i Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, të tilla si hartimi i rregullave të shkruara ku të përcaktohen qartë qëllimi i përdorimit të tyre, aksesimi mbi të dhënat e mbledhura, kohës së ruajtjes së të dhënave, përhapja e imazheve, pozicionet e vendosjes së kamerave, llojit të kamerave të përdorura, informimin klientëve, vendosjes së tabelave etj.

Nisur nga konstatimet e bëra nga grupi i kontrollit administrativ të tilla si:

- Kontrolluesi “Bar Oslo” i regjistruar si person fizik në emër të z. \_\_\_\_\_ mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera (CCTV) në ambientet ku ushtron veprimtarinë e tij .
- Mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave (klientë) nëpërmjet tabelave informuese për mbikëqyrjen e ambienteve me sistem kamerash CCTV;
- Mungesa e rregullave dhe politikave të shkruara për këtë lloj përpunimi të dhënash me sistem kamerash CCTV;
- Pozicionim i gabuar i një kamere e cila kap imazhe në hyrje të paradhomës së tualetit.

vlerësoj se këto konstatime vijnë në kundërshtim me nenet 18 dhe 27 i ligjit nr. Nr.9887, datë 10.3.2008 “Per mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe Udhëzimi nr. 3 për “Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambjente të Ndryshme” dhe në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

## REKOMANDOJ

Në zbatim të neneve 6, 18, 27,28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, kontrolluesi “Bar OSLO” regjistruar si person fizik në emër të \_\_\_\_\_ Tiranë;

- Të marrë masa për hartimin rregullave të shkruara për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale, përdorimit të video-survejimit, regjistrim me kamera, (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë).
- Të bëjë informimin duke u vendosur tabelat informuese në vende të dukshme për përdorimin e video surveimit dhe përpunimin e të dhënash personale, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Të bëjë ripozicionimin e kamerës që është e vendosur në afërsi të paradhomës së tualetit me qëllim që këndi i saj të mos jetë i fokusuar nga tualeti.
- Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë ) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi
- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE**

